



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1296/ 8 prot

Datë 13.05.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 642 / 2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikim i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82256-04-16-2026, me objekt “Shpenzime për realizimin e aktiviteteve të rëndësisë së veçantë”, me fond limit: 4,166,667 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 28.04.2026 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Orelg Gjoni” P.F  
*Adresa: Lagjja nr.3, Rr. Dëshmorët, Z.Kadastrale 1594, nr.pasurie 8/26/1, ish-shtëpia e kulturës, Kolonjë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit  
*Adresa: Rr “Bilal Golemi”, Godina nr. 29, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatori ekonomik ankimues Operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës për ankesën e paraqitur

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82256-04-16-2026, me objekt “Shpenzime për realizimin e aktiviteteve të rëndësishë së veçantë”, me fond limit: 4,166,667 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë **28.04.2026** nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6593, datë 28.04.2026 dhe me nr. 1296/2026 prot., datë 28.04.2026 i operatorit ekonomik “Orelg Gjoni” P.F, mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të Ligjit 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Komisioni me shkresën nr.1296/1 prot., datë 06.05.2026, drejtuar Autoritetit Kontraktor ndër të tjera citon:

[...]Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar, gjithashtu nga shqyrtimi i formularit të ankesës konstatohet se ankesa është me të meta, pasi i mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Për sa më sipër kërkojmë të na informoni në lidhje me administrimin e kësaj ankese pranë institucionit tuaj si dhe me veprimet procedurale të kryera nga autoriteti juaj kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 111/3, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 94/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Referuar nenit 114/1/3/4 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Autoriteti kontraktor nuk ka dërguar asnjë informacion lidhur me ankesën e operatorit ekonomik si edhe informacion mbi pagesën e tarifës së ankimit, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. [...]

II.5. Autoriteti Kontraktor ka përcjellë me shërbim postar shkresën me nr. 973/4 date 04.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1296/2, datë 07.05.2026, me objekt: “Kthim përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit”.

Referuar shkresës mësipër autoriteti kontraktor ka shqyrtuar ankesën, argumentuar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

[...]Autoriteti kontraktor verifikoi ankesën e operatorit ekonomik “Orelg Gjoni” P.F. mbi modifikimet e dokumenteve të tenderit dhe konkludoi se procedura e prokurimit është publikur më datë 17.04.2026 dhe afatet e ankimit fillojnë menjëherë. Ankesa ka ardhur në sistemin Elektronik të Ankesave pranë KPP-së dhe me datë 25.04.2026 pra 11 ditë pas publikimit të procedurës së prokurimit si edhe në të njejtën datë me hapjen e ofertave, 28.04.2026. Në bazë të ligjit 162, neni 110/1/7 ku citohet “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

Për rrjedhojë ankesa rezulton e paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar për ushtrimin e të drejtës së ankimit. Në këto kushte ankesa nuk plotëson kushtet procedurale të vlefshmërisë, nuk mund të merret në shqyrtim dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik ndaj procedurës së prokurimit.

AK nuk legjitimohet të ndërmarë veprime të mëtejshëm në lidhje me këtë ankesë. [...]

II.6. Komisioni, përmes shkresës me nr. 1296/3 prot, datë 08.05.2026 me objekt “Kërkesë për verifikim pagese”, drejtuar Sektorit të Finances, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë KPP-së, me qëllim verifikimin e statusit të pagesës së operatorit ekonomik “Orelg Gjoni” P.F, me përmbajtje si vijon:

*“Komisioni i Prokurimit Publik po shqyrton ankesën me numër ankimimi elektronik A/2026/6593, datë 28.04.2026 dhe me Nr. 1296/2026 Prot., date 28.04.2026 e operatorit ekonomik “Orelg Gjoni” P.F, për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-82256-04-16-2026, me objekt “Shpenzime për realizimin e aktiviteteve të rëndësishme të veçantë”, me fond limit: 4,166,667 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 28.04.2026 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.*

*Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se statusi i pagesës për ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6593 dhe me nr. 1296/2026 prot., datë 28.04.2026 rezulton “pa paguar”.*

*Sa më sipër me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP, lutem përcjelljen e informacionit mbi statusin aktual të pagesës për ankesën e sipërpërmendur.”*

II.7. Në përgjigje të kërkesës më sipër, Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve përmes shkresës me nr. 1296/4 prot., datë 12.05.2026 ka njoftuar KPP si vijon:

*“Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 1296/3 prot., datë 08.05.2026, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr. A/2026/6593, datë 28.04.2026 dhe me Nr. 1296/2026 Prot., date 28.04.2026, operatori ekonomik “Orelg Gjoni” P.F nuk ka paraqitur dokument bankar, që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimimit.*

*Në vijim të kërkesës i është kërkuar Degës së Thesarit raporti për arkëtimet ku sipas verifikimeve të kryera me raportin e dërguar më datë 12.05.2026 nga Dega e Thesarit, për arkëtimet e kryera deri më datë 07.05.2026, rezulton se Operatori Ekonomik “Orelg Gjoni” P.F nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”*

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Orelg Gjoni” P.F, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

Në datën 17.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar ”, me Nr. REF-82256-04-16-2026, me objekt “Shpenzime për realizimin e aktiviteteve të rëndësishme të veçantë”, me fond limit: 4,166,667 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë **28.04.2026** nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

III.1.1. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6593, datë 28.04.2026 dhe me nr. 1296/2026 prot., datë **28.04.2026** i operatorit ekonomik “Orelg Gjoni” P.F, mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar

III.1.1.1. Autoriteti Kontraktor ka përcjellë me shërbim postar shkresën me nr. 973/4 date 04.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1296/2, datë 07.05.2026, me objekt: “Kthim përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit”.

Referuar shkresës mësipër autoriteti kontraktor ka shqyrtuar ankesën argumentuar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

*[...]Autoriteti kontraktor verifikoi ankesën e operatorit ekonomik “Orelg Gjoni” P.F. mbi modifikimet e dokumenteve të tenderit dhe konkludoi se procedura e prokurimit është publikur më datë 17.04.2026 dhe afatet e ankimit fillojnë menjëherë. Ankesa ka ardhur në sistemin Elektronik të Ankesave pranë KPP-së dhe me datë 258.04.2026 pra 11 ditë pas publikimit të procedurës së prokurimit si edhe në të njëjtën datë me haprjen e ofertave , 28.04.2026. Në bazë të ligjit 162, neni 110/1/7 ku citohet “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”*

*Për rrjedhojë ankesa rezulton e paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar për ushtrimin e të drejtës së ankimit. Në këto kushte ankesa nuk plotëson kushtet procedurale të vlefshmërisë, nuk mund të merret në shqyrtim dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik ndaj procedurës së prokurimit.*

*AK nuk legjitimohet të ndërrmarë veprime të mëtejshëm në lidhje me këtë ankesë. [...]*

III.1.2. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.1.3. Në nenin 111, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se:

*“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e*

Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës). ”

III.1.4. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës ”.

III.1.5. Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; ”.

III.1.6. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar (siç është procedura e prokurimit objekt ankimi), në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të kontratës (17.04.2026), ka qenë data 24.04.2026. Ankesa e depozituar në sistemin e ankesave elektronike nga operatori ekonomik “Orelg Gjoni” P.F, është paraqitur në datën 28.04.2026,

jashtë afateve të ankimimit, si pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik, nënjet Sistemit duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të respektojë afatet e ankimimit duke dorëzuar këtë të fundit brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në nenin 118, pika 2, germa “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisë të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Komisioni nga shqyrtimi i formularit të ankesës së operatorit ekonomik “Orelg Gjoni” P.F konstatoi, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.2.1. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë *apriori*, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk çënon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Përsa konstatuar Komisioni kreu verifikime nëpërmjet Sektorit të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë KPP-së. dhe nga informacioni i përcjellë nga Dega e Thesarit me raportin për arkëtimet, ku sipas verifikimeve të kryera në raportin e dërguar më datë 12.05.2026 nga Dega e Thesarit, për arkëtimet e kryera deri më datë 07.05.2026, rezulton se Operatori Ekonomik “Orelg Gjoni” P.F nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar

Në analizë të fakteve të dosjes administrative Komisioni gjykon, se për sa kohë ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Orelg Gjoni” P.F pranë Komisionit Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor nuk plotëson elementët e domosdoshëm të ankesës si mosrespektimit i afateve të ankimit por edhe mungesa e pagesën së tarifës, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit

Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Orelg Gjoni” P.F për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar ”, me Nr. REF-82256-04-16-2026, me objekt “Shpenzime për realizimin e aktiviteteve të rëndësishme të veçantë”, me fond limit: 4,166,667 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 28.04.2026 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

